



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:081582
Datë: 04.03.2025
Numri i dokumentit: 06938558

AN.nr.16/2025

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrativ, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti kryetar i kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Arsim Hamzaj anëtarë, në çështjen e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit, H.S nga Gjakova, të cilin me autorizim e përfaqëson, Arben Biblekaj dhe Fitim Gashi, që të dy avokat nga Prishtina, kundër të paditurës, komuna e Gjakovës, për shkak të kompensimit të pagave përcjellëse, dhe pagave jubilarë, duke vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, dhe Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamentit të Përgjithshëm-Divizioni për Çështje Civile, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;03.03.2025, merr këtë,

A K T V E N D I M

Për gjykimin e çështjes sipas padisë së paditësit, H.S nga Gjakova, është kompetente, Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Çështje Civile, si Gjykatë me kompetencë lëndore dhe territoriale, dhe shkresat e lëndës ti dërgohen në veprim të mëtejme kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Çështje Civile, me aktvendimin C.nr.568/2021, të datës 16.05.2022, është shpallë jo kompetente në pikëpamje lëndore për vendosje në këtë çështje juridike, dhe me të njëjtin aktvendim ka vendosur që pas plotfuqishmërisë së aktvendimit, lëndën me të gjitha shkresat t'ia dërgojë Departamentit për Çështje Administrative pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, si Gjykatë me kompetencë lëndore dhe territoriale, duke u bazuar në dispozitat e nenit 387 të LPK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin A.nr.291/2021, të datës 13.12.2023, ka iniciuar konfliktin e kompetencës, duke mos e pranuar kompetencën lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike, duke theksuar se paditësi nuk kërkon anulimin e asnjë vendimi dhe meqë kontrata kolektive derivon nga Ligji i Punës kompetente për gjykimin e kësaj çështje është, Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, në procedurë kontestimore.

Në bazë të nenit 25.1 të LPK-së, konfliktin lidhur me kompetencën midis Gjykatave të llojit të njëjtë e zgjidh Gjykata që është më e lartë dhe e përbashkët për Gjykatat në konflikt dhe se në

rastin konkret Gjykata e Apelit e Kosovës, si Gjykatë më e lartë dhe e përbashkët për Gjykatat në konflikt ka kompetencë lidhur me zgjidhjen e konfliktit të kompetencës, dhe në bazë të nenit 15.3 të LPK-së, zgjidhjen e konfliktit për kompetencë lëndore dhe territoriale e cakton trupi gjykues prej tre gjyqtarëve.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se kompetencë lëndore për të gjykuar lidhur me objektin e kërkesëpadisë së paditësit, që i referohet kompensimit të pagave jubilarë dhe përcjellëse në pension, është Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Çështje Civile, ngase me nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, është e përcaktuar se *“1. I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij; 1.2. për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 2.Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. 3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.”* Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit nëse e marrin parasysht paragrafin 3, organi i punësimit ka pasur obligim që në mënyrë vullnetare të paguaj detyrimin e saj, për pagesën e pagave jubilarë, ndërsa me vet faktin se organi i punësimit nuk e ka përmbushur detyrimin e saj paditësit i ka lindur e drejta për ti kërkuar edhe përmes procedurës gjyqësore.

Kolegji i apelit vlerëson se paga jubilarë sipas nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, nuk është e lidhur me datën e pensionimit, ndonëse në praktikë ka pasur raste kur Gjykatat këtë të drejtë e kanë lidhur me datën e pensionimit, e që është e pa qëndrueshme dhe në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 52, sepse pagat jubilarë nuk ka asnjë lidhshmëri me pensionimin, dhe si e drejtë nuk ka të bëjë me pensionimin, por me kushtin e arritjes së vitit jubilar, dhe se me arritjen e vitit jubilar lindë e drejta e cila nuk është e përmbushur në mënyrë vullnetare në afatin prej një muaji, rrjedhë e drejta që përveç në procedurë administrative edhe me procedurë gjyqësore të realizohet. Po ashtu sipas vlerësimit të kolegjit të apelit nuk ka ndonjë afat për paraqitjen e kësaj kërkesë, por nëse kalon afati prej tri viteve sa është afati i parashkrimit për këto kërkesa, dhe nëse kërkesa është parashtruar pas afatit prej tri viteve nga momenti i kalimit të një muaji nga lindjes së kërkesës, atëherë kërkesa është e parashkruar dhe nuk mund të realizohet.

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, pasi që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me çështjen juridike anulim të ndonjë vendimi të paditurës, Komuna e Gjakovës kundër të cilit do të mund të iniciohet konflikti administrativ, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me të cilin është përcaktuar se *“1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. 2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar”*. Ndërsa me nenin 14 të LKA-së, përcaktohet se *“Konflikti administrativ mund të filloj edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj”*. Gjithashtu me nenin 9 të LKA-së është përcaktuar se *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.”* Por kemi të bëjmë me pagesën e pagave jubilarë dhe përcjellëse në pension, të drejta këto të cilat burojnë nga Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, e cila ka qenë në fuqi deri me dt.01.01.2018, në këtë kuptim kolegji vlerëson se për objektin e kërkesëpadisë së paditësit kompetencë lëndore për të gjykuar këtë çështje është Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni për Çështje Civile.

Po ashtu kolegji i apelit vlerëson se për objektin e kërkesëpadisë së paditësit nuk është kompetente Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ngase kjo është konfirmuar edhe me aktgjykimin e Gjykatës Supreme ARJ.nr.83/2022, i cili ka aprovuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të parashtruar nga paditësi, A.F etj, dhe ka anuluar aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.nr.255/2022 të dt.18.07.2022, dhe aktvendimin e Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1274/2021 të dt.22.02.2022, me udhëzim që ky departament të vlerësoj kompetencën lëndore për objektin e kërkesëpadisë që i referohet këtu paditësi.

Kolegji i apelit vlerëson se për të përcaktuar natyrën e një konflikti administrativ nuk mjafton që Gjykata të identifikojë vetëm atë që shkruhet në pjesën hyrëse të padisë, ato duhet të shqyrtojnë më tej faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve. Vetëm pas analizimit me kujdes të kërkesëpadisë, të së drejtës subjektive të pretenduar si të shkelur, dhe të faktit të paligjshëm që pretendohet ta ketë shkelur këtë të drejtë subjektive, si dhe pas ballafaqimit të tyre me dispozitat e të drejtës objektive, Gjykata mund të arrijë në një përfundim të saktë mbi natyrën e kontestit, se i njëjti a është kontest që bënë pjesë në kompetencën lëndore të Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Çështje Civile, apo është kontest ndaj të cilit mund të iniciohet konflikti administrativ, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Me dispozitën e nenit 14 të Ligjit Nr.03/L-199 për Gjykatat, (tani nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat), është përcaktuar se “Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore të Prishtinës, gjykon dhe vendosë në Konfliktin Administrativ sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështje të tjera të përcaktuara me ligj”. Ndërsa me nenin 16 të Ligjit Nr.03/L-199 për Gjykatat (tani nenit 20 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat), përcaktohet se “Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore gjykon në shkallë të parë të gjitha çështjet, përveç nëse kjo është kompetence e një Departamenti tjetër të Gjykatës Themelore”. Kurse me dispozitën e nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-199 për Gjykatat, (tani nenit 12 par.1 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat), përcaktohet se “Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe”.

Prandaj, për këto arsye kolegji i apelit vlerëson se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative nuk është kompetente për të vendosur çështjet juridike, ku objekt i kërkesëpadisë së paditësit janë pagat jubilarë, pagat përcjellëse për pension dhe kompensimi i shpenzimeve e ushqimit, përkatësisht dhëniet materiale, e që burojnë nga Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, por kompetencë lëndore për të gjykuar këtë çështje është Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Çështje Civile.

Nga arsyet e dhëna më lart, u vendos si në dispozitiv të aktvendimit në bazë të nenit 25 par.1 të LPK-së, e lidhur me nenin 18 par.1 pika 1.3 të Ligjit për Gjykatat, (tani nenit 22 par.1 pika 1.2 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së.

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet e drejta e ankesës në pajtim me nenin 26.3 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AN.nr.16/2025, datë 03.03.2025

Kryetar i kolegjit,
Hajriz Hoti